



Tiranë më, 11/08/2016

REAGIM PUBLIK

Mbi dhunën e ushtruar ndaj të miturve sipas rasteve të bëra publike në median e shkruar dhe vizive

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve si një strukturë monitoruese e të drejtave të fëmijëve në vend shpreh shqetësimin për numrin në rritje të rasteve të dhunës ndaj fëmijëve, deri në rastet më ekstreme me pasjoë humbjen e jetës së të miturve. I tillë është edhe rasti i 17-vjeçarit i gjendur i pajetë në zonën e groposjes së plehrave në Sharrë, i cili përveçse përbënte një rast të pastër të punësimit informal të të miturve në punë të rënda, ishte një rast i cili solli edhe fundin tragjik të tij si pasojë e neglizhencës dhe mos realizimit të misionit të ngarkuar të strukturave monitoruese shtetërore.

Nga rastet e bëra publike në media rezulton, që për periudhën Janar – Gusht 2016, janë rreth 60 të mitur të abuzuar, ku : 32 raste në komunitet, 15 raste në familje, 7 raste në institucionet arsimore dhe 4 raste në institucionet e përkujdesit shoqëror. Rastet e vdekjes së fëmijëve për shkak të dhunës ose dhe mungesës së sigurisë për jetën gjatë kësaj periudhe është 2.

Rasti i fundit në të cilin 17-vjeçari humbi jetën, ishte një rast i cili lidhet ngushtësisht me mosplotësimin e detyrës dhe misionit të strukturave shtetërore, të cilat kanë në mandatin e tyre jo vetëm hartimin e ligjeve, por edhe zbatimin dhe monitorimin e zbatueshmërisë së drejtë të tyre. Ligjërisht dhe institucionalisht kuadri i mbrojtjes së fëmijës është i garantuar por praktikisht duket që gjërat nuk funksionojnë.

Në përfundim reagimin tonë publik ia adresojmë mbarë shoqërisë, shoqërisë civile e sidomos atyre që veprojnë në fushën e fëmijëve, institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, qeverisjes vendore dhe organizmave ndërkombëtar të cilat mund të ushtrorjnë presion mbi shtetin Shqiptar për t'i parë të drejtat e fëmijëve si një nga prioritetet e tij jo vetëm në letra të shkruara, por duke zbatuar rigorozisht çdo fjali të shkruar në dokumentat ligjorë.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

